



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**  
**Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority**

---

**RAPORTI I PUNËS SË**  
**AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS - AKK**  
**PËR VITIN 2016**

**AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**

Adresa:

Ndërtesa e ish "Bankës së Lubjanës", kati VI

Rruga "Migjeni", pn.

Prishtinë

Tel: 038 200 10 930

Web: <http://ak.rks-gov.net>

Prishtinë  
Mars 2017

## **HYRJE**

Fjala e Kryetarit,

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës si institucion i pavarur e ka përmbyllur vitin 2016 me aktivitete të shumta.

Fillimisht, Komisioni i Autoritetit është emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 09 qershor 2016, me mandat pesë (5) vjeçar, në këtë përbërje:

Valon Prestreshi – Kryetar,  
Ahmet Krasniqi – Zv. Kryetar,  
Fatime Haziri – Anëtare,  
Muhamed Krasniqi – Anëtar dhe  
Shaqir Morina – Anëtar.

Me ardhjen tonë në këtë institucion si organ kolegjal vendimmarrës ne gjetëm Autoritetin në gjendje jo shumë të dëshirueshme. Përveq raportit të Auditimit që ishte në nivel të mirë, neve na u raportua se organet e faktorit ndërkombetar kishin dhënë vërejtjet e tyre të shumta që ky institucion të funksionalizohet në kuptim të vendimarrjes dhe urgjentisht të vendoset në një objekt ku mund të zhvillohet puna normale e tij dhe fatmirësisht, Ministria e Administratës Publike lejoj hapsirat e katit të VI-të në objektin e ish “Bankës së Lubjanës”, i cili akomodim u realizua në fillim të vitit 2017.

Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore Komisioni u angazhua me tërë potencialin e tij profesional që të njoftohet me punën e kaluar të Autoritetit dhe me lëndët e mbetura gjatë periudhës kur Autoriteti nuk kishte Komision. Me vrull dhe entuziazëm Komisioni u fokusua që të përmbushë obligimet e veta ligjore që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe implementimin e objektivave strategjike, siq janë:

- organizimi dhe ngritja e brendshme e Autoritetit,
- kompletimi me legjislacionin sekondar në fushën e konkurrencës në përputhje me direktivat Evropiane,
- monitorimi dhe fillimi i procedurave investiguese për shkelësit e konkurrencës,
- avokimi, mbajtja e trajnimeve dhe njoftimet shitesë për konkurrencën, etj.

Komisioni u përcaktua për hartimin e legjislacionit sekondar gjatë një periudhe 2 vjeqare. Vendosëm që brenda vitit 2016 dhe 2017 Autoriteti të kompletohet tërësisht me legjislacionin sekondar. Nga 6 rregullore të përcaktuara, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016 Komisioni ka hartuar dhe aprovuar 2 rregullore. Rregulloren për Procedurat hetimore do ta përfundojmë në fillim të vitit 2017. Kjo Rregullore konsiderohet ndër rregulloret më voluminoze dhe më të rëndësishmet për këtë institucion.

Gjithashtu Autoriteti ka ruajtur me fanatizëm kontinuitetin e bashkëpunimit me Autoritetet e Konkurrencës të regjionit, duke marrë pjesë në seminarët e organizuar nga RCC dhe UNCTAD, me qëllim të shkëmbimit të përvojave regjionale dhe ngritjes së vazhdueshme profesionale bashkëkohore me direktivat e BE-së.

Autoriteti ynë ishte nikoqir i organizimit të një bashkëpunimi ndër-institucional me Autoritetin e Konkurrencës të Shqipërisë, në të cilin takim kemi bashkëbiseduar për bashkëpunimet e ardhshme ndërmjet dy institucioneve tona, rreth çështjeve të ndryshme që na preokupojnë në fushën e konkurrencës. Ne së bashku trajtuam disa elemente shumë të rëndësishme të cilat janë të ndërlidhura ekskluzivisht me fushëveprimtarinë e konkurrencës, me të cilin bashkëpunim arritëm që të marrim përvojat e mira të Autoritetit të Konkurrencës të Shqipërisë, në aspektin e përafrimit të legjislacionit tonë sekondar dhe hartimin e një plani të aktiviteteve, i cili do të shërbejë si urëlidhëse ndër-institucionale në të ardhmen, e poashtu do të shërbejë edhe si planprogram i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Po ashtu ne kemi bërë edhe shkëmbimin e përvojave tona edhe në aspektin e trajtimit të lëndëve të cilat janë potencialisht të njëjta, që kanë të bëjnë me ç'rregullimin e konkurrencës, me kusht që të përafrojmë mendimet tona në aspektin e strategjive hetimore. Gjithashtu ne trajtuam përvetësimin ose azhurinimin e memoradumit të bashkëpunimit që është i nënshkruar dhe trajtimi i bashkëpunimeve tjera sistematike të cilat do të kenë karakter reciprok.

Brenda kësaj periudhe gjashtë mujore ne u angazhuam edhe në trajtimin e lëndëve të cilat potencialisht kanë të bëjnë me ç'rregullimin e konkurrencës:

- Trajtuam çështjen e mjedrave në dyshim të fiksimit të çmimeve nga grumbulluesit,
- Trajtuam çështjen e Kafeneve në regjionin e Ferizajit për rritjen dhe fiksimin e çmimeve,
- Trajtuam çështjen e marrëveshjeve të ndaluara ndërmjet institucioneve qendore e lokale, të lidhura ndërmjet Postës së Kosovës dhe institucioneve tjera pa procedura konkurruese,
- Trajtuam çështjen e një përqendrimi ku inkasuum taksë në vlerë prej 3.000,00 euro për buxhetin e shtetit,
- Jemi azhur dhe koherent me gjykata, ku në të kaluarën 10 kompani të sigurimeve u denuan në vlerë prej nga 100.000,00 euro për fiksimit të çmimeve dhe lidhje të marrëveshjeve të ndaluara dhe 2 kompani tjera për arka fiskale,
- Kemi bërë avokim të ligjit për mbrojtjen e Konkurrencës me krerët e institucioneve qendore dhe lokale,
- Kemi dhënë një opinionin profesional të kërkuar nga Ministria e Financave, gjegjësisht Departamenti i PPP-së për Stimulim për shërbimet e trajtimit të kufizuar tokësor, i kërkuar nga Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës.

Gjithashtu Autoriteti dhënë kontributin e tij në hartimin e Ligjit për ndihmën shtetërore, i cili ligj u aprovua me 23.12.2016 nga Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Me respekt

Valon Prestreshi  
Kryetar i AKK-së

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me këtë raport ka për qëllim që të sigurojë transparencën e Autoritetit dhe të informojë publikun në përgjithësi dhe bizneset në veçanti lidhur me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në Republikën e Kosovës.

Krijimi i ekonomisë së tregut dhe veprimi i lirë i mekanizmave të tregut është një objektivi me rëndësi për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 10 e përcakton Sistemin Ekonomik të Kosovës si një sistem që bazohet në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.

Politika e mirëfilltë e konkurrencës dhe e nxitjes së konkurrueshmërisë në mes të garuesve në treg ka efekte të shumëfishta pozitive për ekonominë e shtetit, bizneset dhe konsumatorin në veçanti.

Ekonomia jonë, si ekonomi në tranzicion, po përballet me sfida specifike, pasi që sektorë të ndryshëm si energjia, telekomunikacioni, transporti, uji, etj. apo segmente të tyre, veçanërisht për disa lloje shërbimesh, mund të jenë në pronësi të shtetit plotësisht apo pjesërisht, sanksionimi i së cilës ka për rrjedhojë vendosjen apo lejimin e pengesave në hyrje, duke ngadalësuar dhe vështirësuar proceset e ristrukturimit, liberalizimit dhe privatizimit të tregut në këta sektorë.

Tek ekonomitë në tranzicion siç është edhe Republika e Kosovës, tre llojet e praktikave anti konkurruese që janë objekt i ligjit të konkurrencës marrin rëndësi të veçantë, e që këto praktika antikurruese janë: marrëveshjet e ndaluara-kartelet, përqendrimet e ndërmarrjeve dhe keqpërdorimi i pozitës dominuese të ndërmarrjeve me ndikim relevant në treg.

Aktivitetet tjera të politikës së konkurrencës janë parandalimi i abuzimit me pozitën dominuese, ndërprerja e marrëveshjeve me pasoja të rënda për konkurrencën si në nivel prodhimi, shërbimi apo tregtimi dhe për rrjedhim mbrojtja e konsumatorëve, respektimi i konkurrencës së lirë si dhe arritja e efijencës ekonomike nëpërmjet kostos më të ulët të prodhimit dhe ndryshimeve apo përmirësimeve teknologjike.

Në besojmë se ky raport kontribuon në promovimin e mëtejshëm të konkurrencës, si një instrument efektiv i zhvillimit ekonomik, duke siguruar kushte të barabarta për hyrje në treg të të gjitha bizneseve dhe në përmbushjen e kushteve të përfitimeve për konsumatorët.

Bazuar edhe në eksperiencën e vendeve të rajonit në praktikën e funksionimit të Autoriteteve të tyre, në vitin 2016 rastet e hulumtuara, vendimet e marra, analizat e bëra dhe rekomandimet e dhëna e pasurojnë punën e Autoritetit tonë si një institucion relativisht i ri dhe në konsolidim e sipër.

Përmes këtij raporti njoftojmë Kuvendin lidhur me punën e Autoritetit në implementimin e Ligjit të Konkurrencës dhe promovimin e politikave të konkurrencës e cila duhet të krijojë kushte për rritjen ekonomike në bazë të aftësisë konkurruese.

Raporti parqet aktivitetet kryesore që ndërlidhen me konkurrencën dhe mbrojtjen e saj, veprimet e ndërmarra gjatë vitit 2016, duke paraqitë natyrën e konkurrencës si një fenomen ekonomik delikat.

## 2. KORNIZA LIGJORE

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është i ngarkuar për zbatimin e dy ligjeve, të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe të ligjit për ndihmën shtetërore. Nga këto dy ligje burojnë disa akte nënligjore si statuti, udhëzimet administrative dhe rregulloret.

Në vijim po i paraqesim të gjitha me radhë:

- Ligji nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës,
- Ligji nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës,
- Ligji nr. 04/L-024 për ndihmën shtetërore,
- Statuti i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës nr.04-V-312,
- Udhëzimi administrativ nr. 01/2011 mbi kriteret për shqiptimin e masës së sanksioneve administrative,
- Udhëzimi administrativ nr. 02/2011 mbi mënyren dhe kriteret për konstatimin e tregut përkatës – relevant,
- Udhëzimi administrativ nr. 04/2012 për formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit,
- Udhëzimi administrativ nr. 05/2012 për kriteret dhe kushtet për caktimin e marrëveshjeve me vlerë të vogël,
- Udhëzimi administrativ nr. 06/2012 për mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe kriteret për konstatimin e përqendrimit të ndërmarrjeve,
- Udhëzimi administrativ nr. 07/2012 mbi kriteret për lirin ose uljen e masës administrative,
- Rregullore nr. 01/2012/MF për procedurat dhe formatin e njoftimit për ndihmën shtetërore,
- Rregullore nr. 01/2013/MF për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të ndihmës shtetërore,
- Rregullore nr. 01/2016 mbi kushtet dhe rregullat e përdorimit të automjeteve në AKK dhe
- Rregullore nr. 02/2016 e punës së Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Në muajin dhjetor të vitit 2016 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin e ri për ndihmën shtetërore nr. 05/L-100, i cili ka hyrë në fuqi në muajin janar të vitit 2017.

Ligji për mbrojtjen e konkurrencës është i harmonizuar me Direktivat e BE-së, e veçanërisht me Aktet 81, 82 dhe 87 të Komisionit Evropian që në mënyrë të qartë e rregullojnë çështjen e karteleve, marrëveshjeve të ndaluara dhe përqendrimeve të subjekteve të ndryshme ekonomike në treg. Këto direktiva të BE-së (81, 82, 87) tani janë zëvendësuar me nenet 101-107 të Komisionit Evropian.

### 3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 07 nëntor 2008, në bazë të Ligjit për Konkurrencën nr. 2004/36.

Autoriteti është person juridik me autorizime publike i cili në mënyrë të mëvetësishme dhe të pavarur i kryen punët duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës.

Qëllimi i mbrojtjes së konkurrencës është para së gjithash krijimi i përfitimeve për konsumatorët dhe krijimi i kushteve të barabarta për të gjitha bizneset në treg, të cilat duke u sjellur në pajtim me rregullat ekzistuese dhe duke garuar në treg me cilësitë, çmimet dhe inovacionet e produkteve dhe shërbimeve të tyre, i kontribuojnë zhvillimit të përgjithshëm të ekonomisë.

Kur kemi të bëjmë me ndërmarrësit dhe sjelljet e tyre antikonkurruese, si për shembull lidhja e Marrëveshjeve me konkurrentët për çmimet, abuzimi me pozitën dominuese ose kontrolli i përqendrimeve, pra bashkimi dhe zmadhimi i ndërmarrësve, Autoriteti e bënë vlerësimin e sjelljeve të tilla i ndëshkon shkelësit e rregullave dhe ju dërgon mesazhe unike të gjithë pjesëmarrësëve në treg. Pra iniciativat e lira të ndërmarrësve nuk guxojnë të kufizohen, por zhvillimi i tyre kryhet sipas rregullave rigorozë të konkurrencës në treg, të cilat nuk janë vetëm represive, por edhe parandaluese, ndonëse për zhvillimin e konkurrencës efektive kërkohet shumë më tepër e sidomos përforcimi i të kuptuarit dhe ngritja e njohurive lidhur me këto rregulla e cila gjë është objektiv prioritar dhe i përhershëm i Autoritetit.

Një nga detyrat më të rëndësishme të Autoritetit është promovimi i kulturës së konkurrencës dhe hetimi (zbulimi) i kufizimeve të cilat janë të përmbajtura në ligjet dhe rregulloret aktuale të Republikës së Kosovë dhe si të tilla paraqesin pengesa për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe korrekte të ndërmarrësve në treg.

Qëllimi i ynë është që ti kontribuojmë mirëkuptimit të problemit të konkurrencës në treg në të gjitha strukturat e Autoriteteve ekzekutive, legjislative e gjyqësore dhe të marrim pjesë në ndryshimet e tyre, si dhe ta informojmë administratën shtetërore, por edhe shtresat e gjëra të qytetarëve, lidhur me fenomenet të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e konkurrencës.

Nga konkurrenca në fund të fundit përfitojnë të gjithë: konsumatorët, bizneset dhe ekonomia në tërësi. Ajo ofron një ofertë dhe cilësi më të mirë si dhe çmime më të ulëta të produkteve dhe shërbimeve, e inkurajon inovacionin dhe ndikonë në rritjen ekonomike.

Andaj edhe rritja e ndërgjegjësimit për nevojën e promovimit të saj është detyrë e jona.

## **4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI**

### **Struktura organizative e Autoritetit**

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës përbëhet nga **Komisioni** që është organ kolegjal vendimmarrës dhe **Sekretariati** që e përbëjnë nëpunësit civil si staf profesional, mbështetës dhe hetimor.

Komisioni si organ vendimmarrës nga muaji nëntor i vitit 2013 e deri në muajin prill të vitit 2015 ka qenë me vetëm 1 anëtarë, ndërsa nga muaji maj i vitit 2015 e deri në muajin maj të vitit 2016 ka qenë pa asnjë anëtar dhe si i tillë nuk ka marrë asnjë vendim që ndërlidhet me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

### **Struktura organizative e Sekretariatit**

Sekretariati i Autoritetit është organ administrativ i ngarkuar me ligj për të kryer monitorimin dhe hetimin e rasteve për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.

Sekretariati pas monitorimit dhe hetimeve harton raportet të cilat paraqiten pranë Komisionit për vendimmarrje.

Sekretariati sipas Organogramit përbëhet nga dy departamente dhe një zyrë.

### **Departamenti juridik dhe administratës - DJA**

Zhvillon politikat kadrovike dhe planet e Autoritetit për menaxhimin e personelit, koordinon procesin e hartimit të legjislacionit primar dhe sekondar në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, Sekretarin dhe Udhëheqësit e njësive organizative, siguron përputhshmërinë e ligjeve dhe akteve nënligjore të propozuara nga Autoriteti me legjislacionin e Bashkimit Evropian (Acquis Communautaire) si dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Ky departament në bashkëpunim me Komisionin, Sekretarin dhe Udhëheqësit e njësive organizative përgatit planifikimin e buxhetit sipas kategorive ekonomike, siguron përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të KASH-it, SZHMB-së, planit të keshit, pasqyrave e raporteve financiare, barazimet me Thesarin, regjistrimin e të hyrave, si dhe siguron e mbikëqyr shërbimet teknike si mirëmbajtjen, servisimin dhe regjistrimin e rregullt të automjeteve, regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë së Autoritetit në përputhje me legjislacionin në fuqi, etj.

Ky Departament ka 6 (gjashtë) të punësuar dhe ka nevojë për 1 (një) zyrtarë të teknologjisë informative.

## **Departamenti i mbikëqyrjes së tregut - DMT**

Mision kryesor ka hetimin e shkeljeve të konkurrencës në treg, ruajtjen dhe rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, sipas përcaktimeve të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe akteve nënligjore që dalin nga ky ligj.

Ky departament synon që nëpërmjet zbatimit të procedurave hetimore të parashikuara me ligj, të mbikëqyr tregun dhe të propozojë masat e duhura për rivendosjen e konkurrencës në rastet e pengimit, kufizimit apo shtrembërimit të saj në treg, mbikëqyrë hetimin e tregjeve ku shfaqen praktikant anti-konkurrese, si ato të abuzimit me pozitën dominuese në treg, marrëveshjet e ndaluara dhe nëpërmjet përqendrimeve që krijojnë apo forcojnë pozitën dominuese pas përqendrimit, ruan konfidencialitetin zyrtar dhe tregtar për informacionet e dokumentuara, të marra nga bizneset dhe nga institucionet publike, entet rregullatore, shoqatat profesionale e tregtare dhe palë të tjera të përfshira ose jo nën hetim, etj.

Ky Departament ka 6 (gjashtë) të punësuar dhe ka nevojë për 3 (tre) inspektor hetues të konkurrencës dhe për 3 (tre) zyrtarë të lartë të analizës së tregut.

## **Zyra për ndihmën shtetërore - ZNSH**

Zyra për ndihmën shtetërore vepron në bazë të Ligjit për ndihmën shtetërore dhe është përgjegjëse për marrjen, analizën dhe mbikëqyrjen e njoftimeve, mbledhjen e të dhënave në lidhje me skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmën individuale, përgatitë raporte vlerësuese të ndihmave shtetërore si dhe analizimin dhe dhënien e sugjerimeve për të dhënat për ndihmën shtetërore dhe dërgimin tek Komisioni për ndihmën shtetërore.

Zyra ka aktualisht të punësuar vetëm shefen e Zyrës dhe siq cekëm më lartë me Ligjin e ri për ndihmën shtetërore nr. 05/L-100 kjo Zyrë nga muaji shkurt i vitit 2017 është transferuar në Ministrinë e Financave.



## **5. AKTIVITETET PËR PERIUdhËN RAPORTUESE**

### **RASTET - LËNDËT E TRAJTUARA**

#### **1. Rasti i Mjedrave**

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në bazë të kërkesës së Komunës së Podujevës, ka filluar aktivitetin e monitorimit dhe analizimit të tregut të mjedrave në bazë të neni 34, Iniciativa për fillimin e procedurës të Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës.

Për të parë nëse ka kufizim të konkurrencës (marrëveshje apo praktika të bashkërenduara) është analizuar jo vetëm ndikimi i sjelljes mbi konkurrencën nga ana e pikave grumbulluese, por edhe situata e konkurrencës në treg.

Për të gjykuar mbi kufizimin e konkurrencës janë analizuar parametrat e konkurrencës në treg, si për shembull çmimi, sasia e prodhuar, cilësia e produkteve, varieteti i produkteve dhe inovimi në treg. Çmimi dhe sasia e kultivuar janë ndër parametrat më të rëndësishëm të konkurrencës, ku çdo kufizim i lirisë në caktimin e tyre nga ndërmarrjet është i dëmshëm për konkurrencën.

Autoriteti ka mbledhur të dhëna nga pikat e grumbulluesve të mjedrës, prodhuesit e mjedrës, palët e interesuara, institucionet publike (Dogana, Ministria e Bujqësisë, Komuna e Podujevës si dhe Institucione shkencore bujqësore, etj), për të siguruar një pasqyrë të saktë mbi tregun përkatës të këtij produkti.

Analiza e monitorimit të sjelljeve të Grumbulluesve të mjedrës mbi konkurrencën, ka marrë parasysh kontekstin ekonomik duke filluar nga natyra e raporteve të tyre dhe duke vlerësuar më pas fuqinë e kombinuar të tregut të ndërmarrjeve pjesëmarrëse në tregun gjeografik të Kosovës, si dhe faktorë tjerë strukturorë siç janë përqendrimi i tregut, stabiliteti i pjesëve të tregut në kohë, pengesat në hyrje dhe probabiliteti i hyrjes së ndërmarrjeve të tjera në treg (konkurrenca potenciale).

Me konkluzionin e datës 30.08.2016 Autoriteti konstaton se gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun relevant, nuk ka argumente për “Fillimin e Procedurës Hetimore” në kuptim të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Autoriteti në mënyrë aktive ka promovuar njohuritë për konkurrencën në treg, respektivisht vetëdijesimin dhe informimin për rolin e politikës së konkurrencës dhe do të vazhdojë edhe më tutje monitorimin, analizimin dhe sjelljen e grumbulluesve në treg që potencialisht mund të bëjnë shkelje të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

## **2. Rasti mbi dyshimin për Marrëveshje të ndaluar në sektorin e Gastronomisë**

Në fillim të muajit korrik të vitit 2016, Autoriteti ka pranuar kërkesë nga z. Selatin Kaçaniku, Kryetar i Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorit, lidhur me shqetësimet kryesore të konsumatorëve për ngritje çmimesh në gastronomi në rajonin e Ferizajt. Konsumatorët janë ankuar me pretendimet e tyre se ekziston dyshimi i bazuar për një marrëveshje të fshehtë në mes të pronarëve të kafeneve, restoranteve etj, për ngritjen e çmimeve të disa produkteve.

Gjithashtu nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese – BIRN & Internews Kosova-I/KS, Autoriteti ka pranuar raportin hulumtues lidhur me pretendimet e tyre për shkeljen e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nga disa pronarëve të kafeneve në qytetin e Ferizajt.

Gjatë monitorimit të tregut në sektorin e gastronomisë në Komunën e Ferizajt kemi mbledhur të dhënat lidhur me shqetsimet e ngritura nga palët e interesit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit të Komunës së Ferizajt, pronarë të kafeneve dhe restoranteve etj.

Gjatë monitorimit është gjetur se subjektet afarsite në Komunën e Ferizajt janë të organizuar në Shoqatën Hoteliere Turistike.

Gjatë monitorimit të tregut përkatës, mbledhjen e të dhënave dhe deklaratimet e pronarëve të kafeneve të Ferizajt, Autoriteti ka vlerësuar se pronarët kanë arritur një llojë marrëveshje gojore (e cila marrëveshje është e ndaluar apo praktikë e bashkërenduar sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-229, për Mbrojtjen e Konkurrencës), për rritjen e çmimeve në produktet e cekura më lartë, mirëpo marrëveshja nuk ka zgjatur ma shumë se 3 deri në 7 ditë pas sjelljes së saj në treg. Pas ndërhyrjes së Autoritetit është liberalizuar tregu dhe është rikthyer konkurrenca e lire dhe efektive në treg.

Autoriteti vlerëson se kjo marrëveshje është bërë nga mosnjohja e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke e cilësuar si marrëveshje naive dhe për më shumë ajo nuk ka prodhuar ndonjë pasojë apo nuk ka pasur efekt të çrregullimit të ndjeshëm të konkurrencës në treg. Me datën 30.08.2016 Autoriteti ka nxjerr konkluzion për këtë rast.

## **3. Rasti i Marrëveshjes në mes MPB-se dhe Komunitat me IFJB-te**

Autoriteti ka pranuar disa ankesa nga Institucionet Financiare Jobankare (IFJB): Moneta - Sh.p.k., Vllesa Co Sh.p.k., Capital Sh.p.k. me kërkesë për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg ndaj MPB/ARC dhe IFJB Posta e Kosovës Sh.A.

Autoriteti gjithashtu ka pranuar ankesë edhe nga IFJB Propaid Sh.p.k me kërkesë për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg kundër Marrëveshjes së Komunës së Prishtinës me IFJB Posta e Kosovës Sh.A.

Autoriteti në bazë të këtyre ankesave dhe sipas detyrës zyrtare ka filluar shqyrtimin paraprak në tregun relevant.

Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit paraprak në këtë rast është Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet MPB/ARC dhe IFJB Posta e Kosovës Sh.A. dhe Marrëveshjet / Kontratat ndërmjet

komunave të Kosovës me IFJB Posta e Kosovës Sh.A dhe operatorëve tjerë ekonomik në tregun përkatës.

Për të vlerësuar kufizimin e mundshëm të konkurrencës janë analizuar parametrat e konkurrencës në treg dhe kemi përcaktuar tregun përkatës: tregun e produktit dhe tregun gjeografik, si më poshtë;

Struktura dhe shtrirja e Tregut Relevant është përcaktuar duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës nr. 02/2011.

Tregu gjeografik konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.

Tregu përkatës i produktit është Ofrimi i Shërbimit të Pagesave të IFJB-ve.

Në bazë të të gjeturave, gjatë shqyrtimit paraprak të gjendjes në tregun relevant nga dokumentacioni dhe informacionet e siguruara, është konstatuar se ekzistojnë Marrëveshje në mes të:

- Minsitrisë së Punëve të Brendshme/Agjencionit të Regjistrimit Civil (ARC), Qendrat e Regjistrimit Civil (QRC) dhe Qendrat e Regjistrimit të Automjeteve (QRA) nëpër Komunitet e Kosovës me IFJB Posta e Kosovës Sh.a. – pa procedura konkurruese.
- Komunitet e Prishtinës me IFJB Posta e Kosovës Sh.a. – pa procedura konkurruese.
- Komunitet e Gjilanit me IFJB Posta e Kosovës Sh.a. - pa procedura konkurruese.
- Komunitet e Pejës ka shpallur tender për ofrimin e shërbimeve të pagesave, në të cilin tender ka fituar IFJB Vllasa – Co.
- Komunitet e Gjakovës përmes një Kontrate për qiranë e lokalit afaristë e ka instaluar Bankën Ekonomike - pa procedura konkurruese.
- Komunitet e Ferizajt, kishte lidhur një Kontratë për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm me qira me IFJB Vllasa - Co, pa procedura konkurruese.
- Komunitet e Mitrovicës fillimisht ka zhvilluar procedura tenderuese-konkurruese me të cilën fitues është shpallur IFJB Capital Sh.p.k., mirëpo me datën 15.10.2015 Komunitet e Mitrovicës ka arritur Marrëveshje me IFJB Posta e Kosovës – pa procedura konkurruese.

Është konstatuar se përmes këtyre marrëveshjeve të cilat bien ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke u favorizuar IFJB-të e caktuara, ka rezultuar me ndryshimin e strukturës së gjendjes së tregut përkatës në ofrimin e shërbimeve të pagesave, pengim të qasjes së barabartë të konkurrentëve.

Autoriteti vlerëson dhe konstaton se këto Marrëveshje / kontrata bien ndesh me Ligjin nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës, neni 4 paragrafi 1.4.

Si rrjedhojë Komisioni i Autoritetit ka marrë vendim për të Rekomanduar, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Komunitet e Prishtinës, Komunitet e Gjilanit, Komunitet e Mitrovicës, Komunitet e Ferizajt, Komunitet e Gjakovës si dhe të gjitha Autoritetet shtetërore - qendrore dhe locale, që të ofrojnë kushte të barabarta për transaksionet e njejta me operatorët tjerë ekonomik (IFJB), duke i vendosur ato në gjendje të favorshme konkurruese përmes mekanizmave ligjorë, në respektim të ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë, të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

#### **4. Dhënia e mendimit profesional për Drejtorinë Qendrore të Partneritetit Publiko Privat – Ministria e Financave (DQPPP – MF)**

Drejtoria Qendrore e Partneritetit Publiko Privat në Ministrinë e Financave i është drejtuar Autoritetit me kërkesë për dhënien e mendimit profesional lidhur me kërkesën të cilën e ka parashtruar ANP/LIMAK “Adem Jashari”, për skemën "Stimulimi për shërbimet e trajtimit të kufizuar tokësor" (Limited Ground Handling Service Incentive). Produkti i ri i propozuar që është stimulimi për shërbimet e trajtimit të kufizuar tokësor, i cili ofron ulje në pakon GH (ground handling) 50% të pagesave të trajtimit në terren për linjat ajrore që nuk transportojnë mallra të tokës, i është drejtuar linjave ajrore që transportojnë vetëm udhëtarët dhe bagazhet e tyre (aty ku nuk ka lloj përzjerje e trafikut).

Qëllimi i këtij produkti të ri është që të stimulojë shërbime të reja ajrore të ofruara nga / në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP), nëpërmjet reduktimit të shërbimeve të trajtimit të ngarkesave (Cargo). Produkti do të jetë i zbatueshëm për linjat ajrore të cilat i përmbushin kushtet dhe kriteret e caktuara nga koncesionari në bashkëpunim me DQPPP-në. Incentiva e propozuar nga DQPPP dhe LKIA pas dhënies së mendimit profesional dhe sugjerimeve nga Autoriteti, është aprovuar nga Komiteti ndërministror.

#### **5. Telekom i Kosovës kundër IPKO dhe Digit Alb**

Komisioni i Autoritetit ka kërkuar që të kontaktohet pala ankuuese nëse qëndron ende pas kësaj kërke.

#### **6. Hotel Kosova Park kërkesë për dhënjen e pelqimit për ujëra termominerale**

Komisioni i Autoritetit ka marrë vendim që ta mbyllë këtë lëndë pasi që nuk është në kompetencë të Autoritetit për trajtim. Kjo lëndë ka të bëjë me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor.

#### **7. Grupi i studenteve kërkesë për inicimin e marrëveshjes së ndaluar kundër transportit publik në Komunën e Pejës**

Komisioni i Autoritetit ka marrë vendim që ta mbyllë këtë lëndë, pasi që i ka kaluar afatet ligjore.

**8. Rail Trains LLC ndaj Autoritetit Regullativ të Hekurudhave me pretendimet e tij për abuzim me pozitën dominuese**

Komisioni i Autoritetit ka marrë vendim që ta mbyllë këtë lëndë, sepse Rail Trains LLC e ka fituar të drejtën përmes Gjykatës.

**9. ISP kundër Ministrisë së Bujqësisë**

Komisioni i Autoritetit ka kërkuar që të kontaktohet pala dhe të bëhet ripërsëritja e kërkesës, nëse akoma qëndrojnë mbrapa saj.

**10. Ministria e Drejtësisë kundër Kompanive ofertuese në tenderin për servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve të Ministrisë**

Komisioni i Autoritetit ka kërkuar që të kontaktohet pala dhe të bëhet ripërsëritja e kërkesës nëse akoma qëndrojnë mbrapa saj.

**11. Procter & Gamble International, kundër Marketing & distribucioni SHPK, për keqpërdorim të pozitës dominuese**

Komisioni i Autoritetit ka marrë vendim që ta mbyllë këtë lëndë, sepse afati ligjor për ta trajtuar ka kaluar.

**12. Liridon Aliu në emër të banorëve të Hajvalisë kundër Kompanisë 24 Yjet për keqpërdorim të pozitës dominuese**

Inspektorët hetues kanë hulumtuar e monitoruar rasti dhe kemi konstatuar që nuk ka shkelje të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Lënda është mbyllur sipas procedurave ligjore.

**13. Koha Group për fillimin e procedurës hetimore kundër IPKO shpk në lidhje me keqpërdorim të pozitës dominuese në tregun e platformës Digjitale kabllore**

Komisioni i Autoritetit ka kërkuar që të kontaktohet pala dhe të bëhet ripërsëritja e kërkesës nëse akoma qëndrojnë mbrapa saj.

## **PËRQËNDRIMET**

### **Phoenix Pharma DOOEL – Exclusive Pharma Sh.p.k.**

Komisioni i Autoritetit vendosi të autorizojë realizimin e përqendrimit në përputhje me nenin 20, paragrafi 2, të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe neni 20 (1.3) ndërmjet Kompanisë Phoenix Pharma DOOEL Skopje, Republika e Maqedonisë, e cila fiton kontrollin përmes blerjes së 100% të aksioneve mbi Exclusive Pharma Sh.p.k me seli në Prishtinë, Republika e Kosovës.

Autorizimi sipas vlerësimit të Komisionit nuk përbën ndonjë shkelje, kufizim ose dëmtim të konkurrencës efektive në treg ose të një pjese të tij, duke pasur parasysh formimin apo forcimin e pozitës dominuese të pjesëmarrësve në përqendrim dhe si i tillë është në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Me lëshimin të këtij përqendrimi Autoriteti ka inkasuar mjete financiare në shumë prej 3.000,00 euro, sipas dispozitave ligjore.

### **Agrokor d.d. - Mercator d.d.**

Kompania Agrokor d.d. me seli në Zagreb të Kroacisë dhe Mercator d.d. shoqëri aksionare nga Lubjana e Sllovenisë, lidhur me shitëblerjen e aksioneve, me çrast Kompania Agrokor përfiton kontrollin prej 53,12% të aksioneve. Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, neni 20, palët kanë realizuar përqendrimin në treg.

### **Adris Grupa sh.a. - Croatia Osiguranje**

Autoriteti ka pranuar dokumentacionin me objekt “Njoftim për qëllimin e realizimit të përqendrimit”, qëllimin dhe formën e saj në mes të Adris Grupa sh.a. për menxhim dhe investim në Rovinj të Kroacisë.

Në këtë përqendrim kemi të bëjmë me shitjen e aksioneve të Kompanisë shtetërore “CROATIA Osiguranje” të mbi 70% të aksioneve tek Adris Group sh.a. për menxhim dhe investim.

Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, neni 20, palët kanë realizuar përqendrimin në treg.

## **PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT**

Sa i përket politikave të konkurrencës, dispozitat e MSA-së kërkojnë që Republika e Kosovës të zbatojë rregullat e konkurrencës dhe që gradualisht të përafrojë legjislacionin e saj me legjislacionin e BE-së, duke filluar nga hyrja në fuqi e marrëveshjes (nenet 74, 75, të MSA-së). Neni 75 “Konkurrenca dhe dispozitat tjera” definon përgjegjësitë e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe ofron kornizën për funksionimin e marrëveshjes në lidhje me tregtinë mes BE-së dhe Kosovës, në të gjitha marrëveshjet midis ndërmarrjeve, vendimet nga grupe ndërmarrjesh dhe praktikatat e bashkërenduara midis ndërmarrjeve që parandalojnë, kufizojnë ose çrregullojnë konkurrencën.

Marrëveshja mëton përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës me Acquis, implementimin efektiv si dhe sigurimin e mekanizmave të monitorimit dhe transparencës kompatibil me rregullat e BE-së. Në esencë, kjo ka të bëjë me:

- Kartelet dhe marrëveshjet mes ndërmarrjeve,
- Abuzimi me pozitën dominuese dhe
- Bashkimet, blerjet (e një kompanie nga një tjetër) në tregun relevant të Kosovës.

Autoriteti ka përgatitur raportin në baza tremujore të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim (PKZMSA) për vitin 2016, lidhur me masat legislative dhe masat zbatuese në të cilin është përfshirë kostimi dhe buxheti i këtij dokumenti

Janë mbajtur takime të Nën-komitetit të MSA-së për “Tregun e Brendshëm, Konkurrencën, Mbrojtjen e Shëndetit dhe Konsumatorit” ku janë përgatitur dhe dërguar paraprakisht tek Komisioni Evropian, Raporti narrativ për zhvillimet dhe progresin, si dhe është diskutuar për masat e periudhës së ardhshme.

## **Agjenda e Reformave Evropiane (ERA)**

Qeveria e Kosovës është dakorduar me Komisionerin e BE-së për Zgjerim, për një Agjendë Reformash kyçe në funksion të zbatimit të MSA-së. Kjo agjendë do të përfshijë disa çështje kyçe për vitin 2017 dhe do të ketë përkrahjen e nivelit më të lartë politik të vendit tonë.

Nga Ministria e Integritimit Evropian është kërkuar hartimi i një Plani të Veprimit për këtë Agjendë Prioritare.

Në kuadër të kësaj reforme, është caktuar edhe një prioritet për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, i cili është zotuar që gjatë vitit 2017 të përgatisë një analizë dhe raport të përgjithshëm për gjendjen në treg sa i përket monopoleve.

## **Raportimet e ndryshme për KE**

Autoriteti ka përgatitur kontributet (Inputet), për Raportin e KE-së për Kosovën për vitin 2016.

Raportimi në këto fusha është fokusuar në përditësimin dhe zhvillimet gjatë periudhave raportuese të cilat janë të përfshira në Kapitullin e 8-të të Acquis-së: Konkurrenca.

Janë përgatitur dokumente për Komisionin Evropian lidhur me vizitën vlerësuese që ekspertët e tyre ndërmorrën në Kosovë, në janar të vitit 2016 mbi nivelin e zbatimit të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit, nga autoritetet publike dhe operatorët duke përfshirë edhe Autoritetin Kosovar të Konkurrencës.

## **Instrumentet e paraanëtarësimit (IPA II)**

Jemi angazhuar për dokumentin e veprimit IPA II për periudhën 2014 – 2020. Dokumenti vepures në perkrahje të Autoritetit të Konkurrencës dhe Ndoihmes Shtetërore. Me këtë dokument (projekt propozim) është parapare që të mbështetet Autoriteti i Konkurrencës dhe Zyra e Ndiemës Shtetërore në kuader të IPA 2017.

## **BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

### **Bashkëpunimi me UNCTAD - SCF**

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës si anëtar i Forumit të Konkurrencës në Sofje (Sofia Competition Forum – SCF) e cila vepron në kuadër të Konferencës për Tregti dhe Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNCTAD), ka publikuar dy artikuj për edicionin e dytë të SCF-newsletter:

1. Roli i Autoritetit në Ekonominë Nacionale të Kosovës, si asistues në zhvillimin e saj,
2. Zhvillimet e fundit institucionale në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës.

Në kuadër të këtij Forumi, kemi kontribuar finalizimin e projektit për të Drejtat Procedurale të Autoriteteve Nacionale të Konkurrencës, të cilat priten të finalizohen gjatë Forumit të Nëntë në Sofje, në bazë të përgjigjeve të plotësuara nga shtetet anëtare të Forumit.

Si pjesë e ekipit së bashku me Autoritetin Bullgar, kemi marrë përsipër të finalizojmë pjesën e IX-të (Decision – making on competition cases / Vendimmarrja për rastet e konkurrencës) dhe pjesën e X-të (Judicial review / Shqyrtimet gjyqësore).

Sa i përket çështjes në fjalë, qëllimi final është të arrihet një pasqyrë krahasuese në fushën e së drejtës procedurale në vendet e Ballkanit Perëndimor.



Me ftesë të UNCTAD-it kemi marrë pjesë në Seminarin e III-të për Gjyqësorin organizuar në Tiranë. Qëllimi i këtij Seminari ka qenë trajnimi e gjyqtarëve në lidhje me llogaritjen e gjobave dhe masave të nevojshme për garantimin e konkurrencës efektive në treg.

Iniciativa e zyrtarëve të UNCTAD-it ka qenë që çështjet e trajtuara gjatë këtij seminari nuk janë relevante vetëm për Shqipërinë por edhe për aplikimin korrekt të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në Kosovë. Vlenë të theksohet se ftesa për institucionin tonë ka ardhur si rezultat i paraqitjeve dhe raporteve korrekte që kemi pasur me përfaqësuesin e saj z. Pierre Horna, i cili është shprehur gjithmonë i gatshëm të gjejë forma për të asistuar institucionin tonë, marrë parasysht se ne nuk jemi pranuar si shtetë anëtarë i OKB-së.

Komisioni i Autoritetit morri pjesë në Konferencën e organizuar nga UNCTAD-i në Gjenevë të Zvicrës, në të cilën u diskutuan:

- Takimi i shtatë i kërkimit (hulumtimit) të UNCTAD-it lidhur me platformën e partneritetit,
- Tryeza e rumbullakët lidhur me zbatimin e politikës së konkurrencës në sektorin e shitjes me pakicë,
- Tryeza e rumbullakët për vlerësimin e ndërveprimit në mes të objektivave të politikës së konkurrencës dhe të pronës intelektuale,
- Tryeza e rumbullakët lidhur me rritjen e sigurisë ligjore në marrëdhënjet në mes të Autoriteteve të kompetencës dhe Sistemit gjyqësor,
- Shqyrtimi vullnetar profesional lidhur me politikën dhe ligjin e konkurrencës së Uruguajit,
- Sesioni Interaktiv,
- Tryeza e rumbullakët lidhur me përf forcimin e kapaciteteve të sektorit privat për zbatim të konkurrencës,
- Shqyrtimi i ngritjes së kapaciteteve të aktiviteteve të Autoriteteve të reja të konkurrencës.

Siguria ligjore është konsideruar si parim fundamental, i njohur nga shumica e sistemeve juridike në botë. Ky element i sundimit të ligjit e përbën kërkesën për domosdoshmërinë operative të akterëve të ekonomisë të cilët ndërveprojnë në tregun e caktuar. Kështu që rritja e sigurisë ligjore në marrëdhënjet në mes të Autoriteteve të konkurrencës dhe të gjyqësorit kërkon një vendim të nxjerrur nga institucionet e përmendura (me funksion deklarues) me qëllim që të jenë konsekuent për garantimin e një sistemi ligjor të konkurrencës dhe si më e rëndësishme të ofrojnë legjitimitet ndaj pjesëmarrësve në treg.

### **Bashkëpunimi me Sofia Competition Authority**

Në këtë takim kanë marrë pjesë dy anëtarë të Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, ku temë e trajtimit ishte abuzimi i ndërmarrjeve që kanë pozitë dominuese në sektorin e energjisë.

Pjesa e parë pas prezentimit të pjesëmarrësve nga panelistët ka filluar me diskutimin në pika të shkurtra të ndryshimeve në ligjin e BE-së lidhur me ndërmarrjet që kanë pozitën dominuese në sektorin e energjisë dhe mënyra se si të evitohen keqpërdorimet apo abuzimet me pozitën dominuese në sektorin e energjisë.

Në pjesën e dytë kemi qenë të ndarë në dy grupe ku në njerin grup është diskutuar për çmimet përjashtuese abuzive të pozitës dominuese dhe grupi tjetër për keqpërdorimin me çmimet grabitqare apo abuzive nga pozita dominuese.

Në pjesë e tretë jemi përqendruar në diskutime të përbashkëta dhe analiza nga të gjithë pjesëmarrësit.

### **Bashkëpunimi me OECD-GVH Regional Centre for Competition in Budapest (RCC)**

Në këtë seminar i mbajtur në Beograd, morri pjesë një anëtarë i Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, ku temë e trajtimit ishte Avokimi i konkurrencës.

Avokimi i konkurrencës është një temë që mund të trajtohet nga shumë kënde të ndryshme dhe mund të trajtojë shumë aktorë të ndryshëm. Ne do të diskutojmë dhe shkëmbejmë përvojat për avokim për Qeveritë dhe politikëbërësit, komunitetin ligjor, ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha dhe për një publik më të gjerë. Kjo do të përfshijë punën me media, vlerësimin e konkurrencës e ligjeve dhe rregulloreve, vlerësimin dhe promovimin e aktiviteteve të një Autoriteti të Konkurrencës, si dhe idetë për të krijuar dhe promovuar një kulturë të konkurrencës. Një pjesë e këtij programi do të hetojë më nga afër përdorimin e studimeve të tregut dhe hetimet e sektorit. Ekspertët nga juridiksionet me përvojë do të paraqesin pikëpamjet e tyre dhe ne do të kërkojmë një shkëmbim të gjerë në mesin e të gjithë pjesëmarrësve.

### **Bashkëpunimi me OECD – RCC Qendra Regjionale e Konkurrencës në Budapest të Hungarisë**

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjithnjë e më tepër po merrë karakter ndërkombëtar, këtë e dëshmon edhe bashkëpunimi shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm me OECD-në. Gjatë vitit 2016 nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve dhe përvojave, diskutimet lidhur me rastet e shqyrtuara nga Autoriteti ynë, përfshirë edhe rastet hipotetike të ndërtuara nga ekspertët ndërkombëtar të fushës, etj.

Trajnimet e ofruara nga OECD-RCC-ja në Hungari janë shumë të rëndësishme për stafin profesional të institucionit, duke qenë se në këto trajnime diskutohen dhe analizohen çështjet e konkurrencës dhe rregullat e çështjeve konkrete me të cilat ndeshen specialistët e Autoritetit në punën e tyre të përditshme në zbatim të ligjit.

## Bashkëpunimi me Shkollën për Integritet Evropian

Në këtë seminar të organizuar nga SHIE, pjesëmarrëse ishte një anetare e Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, ku temat e trajtimit ishin të fokusuar në të Drejtën e Pronësisë Intelektuale në BE, në legjislacionin e BE-së për Markat Tregtare dhe Indikatorët Gjeografik, në Implikimet e MSA-së – me theks tek rëndësia, konceptet themelore dhe ligji i aplikueshëm ndërkombëtar, etj.

### Përfaqësimet, ankesat dhe kërkesat në gjykata të paraqitura në formë tabelare

Nr.	Emri i Kompanisë	Gjykata	Qëllimi
1	K.S. “Sigal”	Themelore	Përfaqësim, 2 raste
2	K.S. “Sigkos”	Themelore	Përfaqësim, 2 raste
3	A.F. “Dukagjini”	Themelore	Përfaqësim, 1 rastë
4	K.S. “Sigal”	e Apelit	Ankesë
5	K.S. “Insig”	Supreme	Kërkesë për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm të Vendimit Gjyqësor
6	K.S. “Illyria”	Supreme	Kërkesë për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm të Vendimit Gjyqësor
7	K.S. “Elsig”	Supreme	Kërkesë për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm të Vendimit Gjyqësor

### Aktivitetet e ZNSH-së për periudhën raportuese

Zyra për ndihmën shtetërore – ZNSH është përgjegjëse për marrjen, analizën dhe mbikëqyrjen e njoftimeve, mbledhjen e të dhënave në lidhje me skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmën individuale, përgatitjen e raporteve vlerësuese të ndihmave shtetërore si dhe analizimin dhe dhënien e sugjerimeve për të dhënat për ndihmën shtetërore.

Shtyllat kryesore të aktiviteteve të ZNSH-së ishin: kontrolli i ndihmës shtetërore, rrespektimi i skemës egzistuese, avokimi, krijimi i legjislacionit primar dhe sekondar sipas ligjeve të BE-së, për të mundësuar kontrollin e ndihmës shtetërore, si dhe përmes avokimit të ndikoj në ngritjen e vetëdijes tek dhënësit për aplikim të masave dhe zbatim të ligjit.

Ligji i ri për ndihmën shtetërore do të kategorizon ndihmat sipas parimeve bazë që janë të përcaktuara në legjislacionin e BE-së, si:

- Ndalimi i përgjithshëm i ndihmës shtetërore,
- Ndihma e lejueshme dhe përputhshmëria e kushtëzuar e ndihmës shtetërore,
- Ndihma “De Minimis” dhe revokimi i ndihmës shtetërore,
- Parashkrimi i ndihmës shtetërore të kundërligjshme,
- Skemat ekzistuese të ndihmës, etj.

Ligji i ri për ndihmën shtetërore përcakton edhe masat për monitorimin e ndihmës dhe procedurat që duhet të zbatohen nga institucionet dhënëse të ndihmës.

ZNSH-ja është në proces të grumbullimit të të dhënave dhe për mungesë të stafit nuk ka mundur të krijoj një inventar ku pasqyrohen të dhënat lidhur me skemat dhe zbatueshmërinë e rregullave për ndihmën shtetërore.

ZNSH-ja që nga themelimi i saj në dhjetor 2013 e deri më tani, ka zhvilluar aktivitetet e saja duke njoftuar dhënësit e ndihmave shtetërore me formën e njoftimeve, mënyrën e plotësimit të formularit dhe afatet ligjore që janë të përcaktuara me Rregulloren e formatit të njoftimit.

ZNSH-ja gjatë vitit 2016 ka arritur që të zhvillojë aktivitetet e saj edhe në fushën e bashkëpunimit, duke mbajtur takime me zyrtarët e BE-së dhe KE-së – Zyrën ndërlidhëse në Prishtinë, ku fokusi i bisedimeve ka qenë i lidhur me funksionalizimin dhe plotësimin e legjislacionit për ndihmën shtetërore, trajnimet përmes programit të IPA II, përmbushja e standardeve sipas afateve kohore që janë të cekura në MSA.

ZNSH-ja ka funksionuar vetëm me një të punësuar, që ka bërë të pamundur zhvillimin e aktiviteteve të domosdoshme për monitorimin e ndihmës shtetërore nga institucionet dhënëse.

MIE dhe institucionet tjera kanë kontribuar në plotësimin e kërkesave për PKZMSA-në, ku takimet me donatorë është paraqitur nevoja për përkrahje në zhvillimin e sektorit të ndihmës shtetërore, takimet me ekspertë ndërkombëtar për kompletimin e legjislacionit dhe kordinimi me MIE dhe ekspertin e caktuar për përkrahje të Autoritetit në hartimin e draft-programit IPA II 2014-2020. Aktivitetet tjera të ZNSH-së kanë qenë kryesisht në frymën e bashkëpunimit dhe informimit për mundësinë e përkrahjes në ngritjen e kapaciteteve.

Fokusi i ZNSH-së ka qenë në hartimin e projektligjit të ri për ndihmën shtetërore. Shefja e ZNSH-së ka qenë pjesë e Komisionit për hartimin e projektligjit dhe ka paraqitur komentet e saj në Komision, duke kontribuar në ndryshime esenciale të strukturës së KNSH-së dhe ZNSH-së. Ajo propozoi që ZNSH-ja të avancohet në Departamenti për ndihmën shtetërore - DNSH dhe të veprojë në kuadër të Ministrisë së Financave, kurse KNSH-ja të ndryshojë përbëjen dhe një nga anëtarët e saj të jetë edhe kryetari i Komisionit të AKK-së.

Më 28 qershor 2016, është mbajtur takimi me Grupin punues sektorial për koordinim me donatorët për ekonomi, tregti dhe industri, ku para donatorëve u shtrua nevoja e përkrahjes së sektorit të ndihmës shtetërore.

Më 04 Tetor 2016, në MZHE u mbajtë takimi lidhur me misionin e planifikuar të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Kosovë.

Gjatë muajit janar 2016, ZNSH-ja ka punuar në plotësimin e inpueteve të draftit të PKAA-së për tu proceduar më tutje në MIE, kurse në muajin shkurt ka punuar në dokumentin planifikues të programit IPA II 2014-2020 dhe në përgatitjen e implementimit të metodave dhe financimit të projekteve për IPA II 2014-2020.

Në bashkëpunim me MIE-në kemi punuar në plotësimin e dokumentit planifikues sektorial, përfundimin e dokumentit të IPA II për planin e veprimit të SPD-së - Action Documents dhe dërgimi i dokumentit final në MIE.

ZNSH-ja ka përgatitur raportin me të dhënat për procesin e legjislacionit primar dhe të dhënat tjera të cilat janë kërkuar nga MIE-ja për Raportin e Progresit si dhe takimet e realizuara për hartimin e Planit Kombëtar të Republikës së Kosovës për adaptimin e ACQUIS, pas nënshkrimit të MSA-së nga Republika e Kosovës.

## **Bashkëpunimi ndërkombëtar (trajnimet, seminarët dhe punëtorit)**

ZNSH-ja ka bashkëpunim me shumë institucione ndërkombëtare siq janë: Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë, Zyra Ndërlidhëse e Bashkimit Evropian në Prishtinë, Drejtoria e Përgjithshme e Konkurrencës – Sektori për ndihmë shtetërore në Bruksel, Sektori i ndihmës shtetërore në Shqipëri, Autoriteti i ndihmës shtetërore në Bullgari, Departamenti i ndihmës shtetërore në Maqedoni, etj.

Sa i përket trajnimeve, punëtorive dhe seminareve, kemi marrë pjesë vetëm në një punëtori të organizuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë. Temat kryesore ishin: Nocioni i ndihmës shtetërore, Njofimi për ndihmën shtetërore, Kontrollimi i afateve ligjore të ndihmave shtetërore të paligjshme, etj. si dhe shembuj praktik nga BE-ja.

Bashkëpunimet tjera kanë qenë me institucionet vendore, ku kryesisht kanë qenë takime për kërkesat që dalin nga MSA-ja, bashkëpunimi me MIE-në për planin kombëtar të PKAA-së.

ZNSH-ja i është përgjigjur edhe kërkesave dhe pyetësorëve nga CEFTA-së si dhe kemi pasë bashkëpunim me Ambasadën Britanike në Kosovë për mundësinë e përkrahjes së ZNSH-së në ngritjen e kapaciteteve.

## **6. SFIDAT DHE REKOMANDIMET E INSTITUCIONIT**

### **Sfidat e Autoritetit gjatë vitit 2016**

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë ushtrimit të detyrave të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, vazhdon të jetë i ballafaquar me sfida si të aspektit teknik, organizativ e funksional, siq janë:

- Mungesa e Komisionit të Autoritetit (deri në qershor të vitit 2016),
- Mungesa e hapësirave (zyrave) për punë normale (deri në shkurt të vitit 2017),
- Buxheti dhe stafi i pamjaftueshëm,
- Bashkëpunimi i pamjaftueshëm me rregullatorët tjerë të tregut,
- Mundësitë e kufizuara për trajnim të stafit,
- Njohuritë jo të mjaftueshme të gjykatësve nga fusha e mbrojtjes së konkurrencës,
- Mbështetje jo të mjaftueshme nga komuniteti i biznesit dhe konsumatorët, etj.

Tani kur shumica e sfidave të përmendura janë tejkaluar, besojmë se edhe ato të mbeturat, bazuar në zotimet e Komisionit të ri të Autoritetit do të eliminohen, aq më tepër kur kemi të bëjmë me faktorë kryesisht formal, sikurse që janë buxheti, stafi i pamjaftueshëm dhe mbështetja jo e mjaftueshme nga komuniteti i biznesit dhe konsumatorët, etj.

Prandaj gjatë vitit 2017, me kushte të reja dhe mobilizim plotësues Autoriteti do të përgatitet për pjesmarrje aktive në punën e organeve dhe grupeve punuese të rrjetit Evropian për mbrojtjen e konkurrencës në treg, me të cilat bashkëpunimi është i detyruar.

Përgatitjet më të rëndësishme megjithatë janë duke u bërë për përfundimin e aktivitetit të Autoritetit lidhur me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe të dispozitave tjera nga ky fushëveprim me qëllim që të fuqizohet konkurrenca në treg në Republikën e Kosovës dhe ndërmarrësit Kosovar të largohen (zbrapsen) nga thyerja e këtyre dispozitave ligjore, kurse në rastet kur kemi të bëjmë me shkeljet e rënda të dispozitave ligjore, ata të ndëshkohen në mënyrë meritore për sjelljet antikonkurrese.

### **Rekomandimet e Autoritetit për vitin 2017**

Viti 2017 korrespondon me vitin e parë të plotë, pas funksionalizimit të Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, pas tri viteve të pasivitetit të tij, sepse ai definitivisht në formacion të plotë u emërua me 09.06.2016.

Në përputhje me objektivat strategjike dhe operacionale të përcaktuara për vitin 2017 dhe në përputhje me dispozitat e pikës së dhjetë të paragrafit të parë të nenit 28 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, si dhe të pikës së parë të paragrafit të dytë të nenit 12 të Statutit, Autoriteti rekomandon si prioritet të politikës së konkurrencës për vitin 2017, këto aktivitete:

#### **- Prioriteti i parë**

##### **Të formuarit e një autoriteti aktivë për mbrojtjen e konkurrencës duke kërkuar në mënyrë proaktive zbulimin e praktikave anti-konkurrese në vitin 2017.**

Autoriteti do ta forcojë aftësinë e tij për zbulimin e praktikave të kufizimit të konkurrencës dhe atë sipas detyrës zyrtare (*ex officio*), si një mjet thelbësor për hetimin dhe sanksionimin e veprimeve të paligjshme, me qëllim të zhbindjes (zbrapsjes) së sjelljeve ilegale dhe në këtë mënyrë të ndikoj në rritjen e stimujve të konkurrencës për kompanitë që të garojnë në mes veti me anë të meritës.

a. Në veçanti, lidhur me prokurimin publik, Autoriteti do të vazhdojë të punoj **për analizimin e informacionit për procedurat e prokurimit publik** në sektorët e shpenzimeve të rëndësishme publike kombëtare, me qëllim të identifikimit të gjurmëve të marrëveshjeve të fshehta.

b. Në mënyrë që të rritë veprimtarinë hetimore **në vitin 2017, do të bashkëpunoj me parashtruesit e ankesave**, si një nga burimet kryesore të informacionit për zbulimin e praktikave kufizuese. Për këtë qëllim, do të zhvillohet zbatimi i ankesave të reja në portalet elektronike, si dhe do të instalohet një linjë e dedikuar telefonike. Këto instrumente pretendojnë për ta lehtësuar paraqitjen e ankesave për Autoritetin nga qytetarët dhe kompanitë të cilët janë viktima potenciale të sjelljes anti konkurrese, ose të cilët janë në dijeni të praktikave të paligjshme. Këto instrumente do të sjellin efikasitet më të madh operacional për zhvillimin e shpejt dhe në mënyrë efektive të hetimeve.

c. Gjatë vitit 2017, Autoriteti në vazhdimësi do të **përmirësojë procedurat e saj të brendshme** në mënyrë që ta zvogëlojë kohën për hetimin e kufizimeve të konkurrencës dhe për të rritur sigurinë juridike për kompanitë.

d. Në vitin vijues 2017, për luftimin e praktikave të cilat e kufizojnë konkurrencën do të **përdoren mjetet hetimore efikase dhe të kombinuara**. Gjatë këtij viti Autoriteti do të përdorë mjetet më të përshtatshme për nxjerrjen e dëshmive, duke e bërë konsolidimin e procedurave për kryerjen e hetimeve, veçanërisht në ambientet digjitale, si dhe për trajtimin e provave të mbledhura. Ai do të ketë **përfitime edhe nga mos respektimi i skadencave të afateve ligjore për ushtrimin e ankesave lidhur me Aktgjykimet e nxjerra jo përfundimtare**.

#### **- Prioriteti i dytë**

##### **Luftimi karteleve në ekonominë e Republikës së Kosovës**

Në vitin 2017, lufta kundër karteleve do të jetë njëri prej prioriteteve të Autoritetit, sepse ato i sjellin dëm ekonomisë kombëtare dhe konsumatorëve, qofshin ata si ndërmjetësues ose si akterë të fundit.

Koordinimi në mes të kompanive konkurruese, duke i fiksuar e çmimet, mandej duke e bërë ndarjen e tregjeve gjeografike ose të konsumatorëve, apo duke e bërë kufizimin e prodhimit në atë mënyrë e cila mundëson rritjen e çmimeve, është shkelje më e rëndë e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Autoriteti do ta bëjë promovimin e luftës kundër karteleve, pavarësisht nga lloji ose forma konkrete e Marrëveshjes së tregut relevant (përkatës), apo të madhësisë së kompanive, duke i kushtuar vëmendje të veçantë **prokurimit publik**, por edhe marrëveshjeve të cilat ndikojnë te konsumatorët e fundit në mënyrë më të drejtpërdrejtë.

Në këtë kontekst, Autoriteti do ta vendosë në prioritetet e aktivitetit të saj edhe promovimin e programit të lehtësimit të ndëshkimeve, i cili siguron imunitet ose ulje të gjobave për kompanitë apo për administratorët, nëse ata e pranojnë pjesëmarrjen e tyre në një kartel dhe nëse bashkëpunojnë me hetuesit e Autoritetit. Rritja e ndërgjegjësimit për programin e lehtësimeve do ti përfshijë edhe palët e angazhuara të interesit, duke përfshirë komunitetet ligjore dhe të biznesit në Republikën e Kosovës.

Programi i lehtësimit (zbutjes) do të përforcohet edhe më tej me miratimin e vendimeve sanksionuese. Këto vendime do të jetë ligjërisht dhe ekonomikisht të shëndosha dhe do të parashikojnë sanksione të duhura për objektivat e parandalimeve të veçanta dhe të përgjithshme.

Pas deklarimeve të dhëna në vitin 2016 për ti luftuar manipulimet e ofertave në prokurimin publik, Autoriteti do të bashkëpunoj ngushtë me organet vendimmarrëse dhe organet tjera përgjegjëse në prokurimin publik. Ky bashkëpunim ka për synim shkëmbimin e praktikave më të mira të cilat e lehtësojnë jo vetëm parandalimin, por edhe zbulimin e marrëveshjeve të fshehta në procedurat e prokurimit publik.

#### **- Prioriteti i tretë**

##### **Praktikat tjera të cilat e kufizojnë konkurrencën në ekonomi**

Përveç luftës kundër karteleve, prioritetet e Autoritetit gjithashtu përfshijnë edhe hetimin dhe sanksionimin e kufizimeve vertikale të konkurrencës, të tilla si ruajtja e çmimeve të rishitjes ose mbrojtja absolute territoriale e distributorëve, si dhe abuzimi me pozitën dominuese.

### **Marrja e vendimeve me transparencë**

Përdorimi i sanksioneve për shkeljet e ligjit të konkurrencës duhet të bazohet në rolin e tyre për parandalimin e veçantë dhe të përgjithshëm, të të penguarit e shfaqjeve dhe sjelljeve të paligjshme.

Gjatë ushtrimit të kompetencave të tij për ndëshkim në përputhje të plotë me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, Autoriteti do të zbatojë sanksionet në përputhje me udhëzimin e publikuar për aplikimin e gjobave.

Në vitin 2017, Autoriteti do të vazhdojë të promovojë procedurat e zgjidhjeve dhe të angazhimeve, në të cilat kërkohen, instrumentet me përfitime në aspektin e arritjeve të efikasitetit të procedurave.

Në veprimtarinë e tij, Autoriteti do t'i kushtojë vëmendje të afërt të drejtave të mbrojtjes dhe procesit të rregullt.

### **Kontrolli më efikas i bashkimit (përqendrimit)**

Në kontrollin e bashkimit (përqendrimit), Autoriteti do të përcaktojë si prioritet shpejtësinë dhe efikasitetin e veprimeve të tij dhe atë si në bashkimet komplekse ashtu edhe në ato jokomplekse. Autoriteti do të synojë reduktimin e barrës burokratike të palëve në procedurat e kontrollit të bashkimit.

Në vitin 2017, Autoriteti do ta zvogëlojë kohëzgjatjen mesatare të procedurave të bashkimit, rreth 5% deri në 10%.

Autoriteti gjithashtu do të përforcojë zbulimin e bashkimeve (përqendrimeve) të cilat, pavarësisht nga përmbushja e kriteve të njoftimit, nuk janë paraqitur tek Autoriteti.

Qëllimi i Autoritetit është ruajtja dhe zhvillimi i interesit të konsumatorëve të ndërmjetëm dhe të atyre të fundit, në konkurrencën efektive në treg, siç parashihet në Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

## **Sfidat e ZNSH-së gjatë vitit 2016**

Zyra për ndihmën shtetërore – ZNSH, ka funksionuar në kuadër të Autoritetit dhe që nga themelimi është ballafaquar me sfidat e hartimit të Ligjit të ri për ndihmën shtetërore, kompletimin me akte nënligjore, krijimin e inventarit të skemave të ndihmave shtetërore, krijimin e hartës regjionale të ndihmave shtetërore, kompletimin e stafit, etj.



## Rekomandimet e ZNSH-së për vitin 2017

Rekomandimet e ZNSH-së (me Ligjin e ri për ndihmën shtetërore nr. 05/L-100, tani Departamenti për ndihmën shtetërore – DNSH) do të vinë nga Ministria e Financave, ku siq cekëm më lartë është transferuar nga muaji shkurt i vitit 2017.

### 7. RAPORTI FINANCIAR

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka përgatitë raportin financiar për vitin 2016 sipas formës së formularit të përcaktuar nga Komisioni për buxhet dhe financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe është pjesë përbërëse e këtij raporti të punës.

### 8. RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZAP-it

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka përgatitur planin e zbatimit të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm - ZAP, në bazë të raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2015.

Në vijim po japim të gjeturat, rekomandimet, veprimet e menaxhmentit, datat e planifikuara të përfundimit të veprimit të menaxhmentit dhe personin përgjegjës.

Nr.	E gjetura dhe Rekomandimi	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar e përfundimit të veprimit të menaxhmentit	Personi përgjegjës
1	<b>E gjetura:</b> Pjesa më e madhe e rekomandimeve të vitit të kaluar janë adresuar dhe disa prej tyre janë implementuar plotësisht. Megjithatë, mbeten ende disa rekomandime të cilat përsëriten nga viti në vit. Kjo për shkak se AKK-ja nuk ndjek një proces formal të monitorimit për të siguruar implementimin e të gjitha rekomandimeve të AP-së.	Mungesa e Komisionit të AKK-së për më shumë se dy vite dhe moszgjidhja e akomodimit që nga themelimi i AKK-së më 2008, ka sjellë vështirësi edhe në implementimin e të gjitha rekomandimeve të ZAP-it. Mbetemi me shpresë se me emërimin e Komisionit dhe	31.12.2016	Sekretari i AKK-së.

	<p><b>Rekomandimi:</b> Sekretari i AKK-së duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implemtimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.</p>	<p>zgjidhjen e problemit të akomodimit do të jenë më të pakta rekomandimet e ZAP-it në të ardhmen.</p>		
2	<p><b>E gjetura:</b> Pyetëtori i vetëvlerësimit i plotësuar nga AKK-ja ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. Kjo është ndikuar në masë të madhe edhe nga mungesa e Komisionit të AKK-së. Veç kësaj, AKK-ja është duke u përballur me vështirësi në kryerjen e përgjegjësive dhe në arritjen e objektivave organizative. Kjo ngase vendimet lidhur me inspektimet e tregut hynë në kuadër të përgjegjësive të Komisionit të AKK-së.</p> <p><b>Rekomandimi:</b> Sekretari i AKK-së duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.</p>	<p>Menaxhimi i rrezikut është çështje që nuk e kemi trajtuar asnjëherë dhe do të bëjmë përpjekje maksimale që ta trajtojmë në të ardhmen.</p>	31.12.2016	Sekretari i AKK-së.
3	<p><b>E gjetura:</b> Menaxhmenti i AKK-së nuk mban takime të rregullta me zyrtarët në zingjirin llogaridhënës, së paku mbajtja e takimeve nuk është dokumentuar në formën e një procesverbali ose në formën e raporteve. Po ashtu, mungon edhe raportimi me shkrim i dokumentuar nga zyrtarët për buxhet dhe financa dhe burime njerëzore. Këto kanë ndikuar që kontrollat të jenë jo efektive në</p>	<p>Mungesa e Komisionit në një farë mënyre, paralizon funksionimin e AKK-së dhe nga ky fakt takimet e menaxhmentit janë të rralla. Nuk e dimë çfarë keni menduar te raportimi me shkrim i dokumentuar nga zyrtarët për buxhet e financa dhe burime njerëzore, por në këto dy fusha</p>	Me emërimin e Komisionit të AKK-së.	Komisioni i AKK-së.

	<p>veçanti në fushën e pasurisë dhe të pagesave.</p> <p><b>Rekomandimi :</b> Sekretari i AKK-së duhet të shqyrtojë aranzhimet ekzistuese të raportimit për të siguruar që mangësitë të identifikohen, dokumentohen dhe raportohen me kohë me qëllim të evitimit të tyre.</p>	<p>mendojmë se nuk ka pasur aspak mangësi.</p> <p>Pagesat janë kryer gjithnjë me kohë, nëse mendoni në pagesën e fillim-vitit në shumën 120,00 euro, për vonesën e saj, faji qëndron te OE që e ka dhënë llogarinë e bankës pa qenë aktive në MF.</p>		
<b>4</b>	<p><b>E gjetura:</b> Edhe pse AKK-ja kishte përgatitur një plan të veprimit ku ishin vendosur afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të NjAB-së, 1 nga 3 rekomandimet e dhëna nuk ishte implementuar ende dhe që ndërlidhet me emërimin e Komisionit. Implementimi i këtij rekomandimi nuk varet nga menaxhmenti i AKK-së duke ditur se anëtarët e Komisionit emërohen nga Kuvendi.</p> <p><b>Rekomandimi:</b> Sekretari i AKK-së ti drejtohet organit vendimmarrës me kërkesë për emërimin sa më të shpejtë të anëtarëve të Komisionit duke i sjellë në vëmendjen e tyre pasojat nga mungesa e bordit.</p>	<p>Emërimi i Komisionit të AKK-së është çështje që tërësisht varet nga Qeveria dhe Kuvendi.</p>	<p>1. Nuk varet nga AKK-ja.</p>	<p>1. X</p>
<b>5</b>	<p><b>E gjetura:</b> Sipas rregullës së thesarit nr. 02/2013 neni 18, çdo organizatë buxhetore obligohet të bëjë inventarizimin e pasurisë. AKK nuk ka bërë inventarizimin e pasurisë së saj për vitin 2015. Kjo sipas zyrtarëve përgjegjës ka ndodhur përshkak të vështirësive gjatë procesit të akomodimit të përkohshëm në zyret e reja.</p> <p><b>Rekomandimi:</b> Sekretari i AKK-së duhet të sigurojë që të kryhet inventarizimi i pasurisë çdo fund vit,</p>	<p>Gjatë tërë vitit 2015 kemi qenë të akomoduar në vetëm dy zyra në objektin e Kuvendit të Kosovës me inventar të Kuvendit.</p> <p>Inventari ynë ka qenë i magazinuar në depo të Kuvendit dhe inventarizimi i tij ka qenë i pamundur.</p> <p>Në bazë të vendimit të MAP-it, AKK-ja duhet të akomodohej në katin e gjashtë (6) të ish-objektit të Bankës së Lubjanës.</p>	<p>31.12.2016</p>	<p>Zyrtari i pasurisë</p>

për të qenë në dijeni të gjendjes së pasurisë të cilën e zotëron AKK-ja.	Në momentin e akomodimit në këtë objekt do të bëjmë inventarizimin detal të të gjithë inventarit të AKK-së.		
--	---	--	--

## 9. SHTOJCAT

### ORGANOGRAMI i AKK-së

#### K O M I S I O N I

Kryetari	(1)
Zëvendëskryetari	(1)
Anëtarët	(3)

#### S E K R E T A R I A T I

Sekretari	(1)
-----------	-----

<b>DEPARTAMENTI JURIDIK DHE ADMINISTRATËS</b>	<b>DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES SË TREGUT</b>	<b>ZYRA PËR NDIHMËN SHTETËRORE</b>
Drejtori (1)	Drejtori (1)	Shefi (1)
Zyrtari i Lartë Ligjor (1)	Inspektori për Hetimin e Shkeljeve të Konkurrencës në Treg (5)	Zyrtari i Lartë për Ndihmën Shtetërore (4)
Zyrtari i Lartë për Buxhet e Financa (1)		
Zyrtari i Lartë i Personelit (1)		
Asistenti		

Ekzekutiv (1)
Vozitësi (1)

**Vërejtje:**

Në kllapa është numri i pozitive.